

Sevdail Demiri, PhD¹

**SHQIPTARËT E SHKUPIT DHE KUMANOVËS NË BETEJAT PËR
BASHKIM DHE FLAMUR KOMBËTAR**

**АЛБАНЦИТЕ ОД СКОПЈЕ И КУМАНОВО ВО БИТКИТЕ ЗА
ОБЕДИНУВАЊЕ И НАЦИОНАЛНО ЗНАМЕ**

**ALBANIANS OF SKOPJE AND KUMANOVO IN THE BATTLES FOR
UNITY AND A NATIONAL FLAG**

Abstract

The regions of Skopje and Kumanovo in which the Albanians are majority have been part of all historical and political developments throughout the centuries-old struggles for freedom, unity, and a common national flag.

In this scientific paper, we will briefly dwell on some key moments of this continuous effort of the Albanians of the Skopje and Kumanovo region.

Before the independence of Albania was declared in Vlora on November 28, 1912, Skopje had been liberated by thousands of Albanian insurgents in August 12 of that year. Since in the following period these territories remained under the rule of the Serbo-Croatian-Slovenian Kingdom, the situation of the Albanians was very difficult.

During World War II, the Albanians made new efforts in these regions to fight for unification with Albania. After the capitulation of fascist Bulgaria, in mid-September 1944, Albanian nationalist forces liberated Skopje and the Kumanovo highlands and raised the two headed eagle red-black flag. With these ideals, they continued the resistance under the Albanian National Democratic Organization and later with the Illegal Movements.

¹ Autori Sevdail Demiri është doktor i shkencave historike, këshilltar shkencor/profesor ordinar në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Email: sevdaildemiri@itsh.edu.mk

These efforts spread during 1968, when the 500th anniversary of the death of the Albanian national hero, Skanderbeg, was marked, when Albanians who raised the Albanian flag were imprisoned and mistreated by the Yugoslav police forces.

These tendencies of the Albanians of Skopje and Kumanovo, in their continuous efforts for unity and a national flag, were also during the recent liberation wars in Kosovo (1998-1999) and in Macedonia (2001).

Keywords: *Skopje, Kumanovo, war, unification, flag, Albania*

1. Hyrje

Shqiptarët e rajonit të Shkupit dhe Kumanovës, që përbëjnë viset kufitare të Trevave Lindore Shqiptare, historikisht kanë qenë pjesë e pandashme e të gjitha ngjarjeve të rëndësishme historike, që nga lashtësia e deri në ditët e sotme, por shpeshherë edhe promotorë dhe eksponentë kryesorë të zhvillimeve të rëndësishme kombëtare. Megjithatë, padrejtësitë historike ndaj shqiptarëve nëpër konferenca ndërkombëtare, lënduan thellë palcën kombëtare, duke copëtuar trojet arbërore pabesisht në disa pjesë. Këtë fat të keq e pati edhe rajoni i Shkupit dhe Kumanovës, ku gjatë shekujve zëri i shqiptarëve u ndie edhe brenda portave të perandorive dhe sunduesve të padrejtë.

Megjithëkëtë, treva e gjerë e maleve të Karadakut, ku ngjitet edhe lugina e Shkupit dhe Kumanovës, gjatë historisë ka bërë rezistencë të pashoqe për të mbrojtur nderin e kombit dhe flamurin kuqez. Prandaj, në këtë punim shkencor, shkurtimisht do të ndalemi nëpër disa momente kyçe të kësaj përpjekjeje të vazhdueshme të shqiptarëve të kësaj ane.

Para se të shpallej pavarësia e Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912, Shkupi ishte çliruar nga mijëra kryengritës shqiptarë që nga 12 gushti i atij viti. Meqë në periudhën vijuese këto treva mbetën nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, gjendja e shqiptarëve ishte shumë e vështirë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore rizgjohen përpjekjet e shqiptarëve të këtyre trevave në luftën për bashkim me Shqipërinë. Pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste, në mesin e shtatorit të vitit 1944, forcat nacionaliste shqiptare e çlirojnë Shkupin dhe malësinë e Kumanovës dhe e ngritin flamurin kuqez. Me këto ideale e vazhduan rezistencën nën Organizatën Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSh)

dhe më vonë me Lëvizjet Ilegale, duke u masivizuar gjatë luftërave të fundit çlirimtare në Kosovë, Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni.

2. Çlirimi i Shkupit nga forcat shqiptare më 1912

Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 Nëntor 1912, në Vilajetin e Kosovës (me qendër Shkupin) i kishin paraprirë një sërë ngjarjesh dhe aksionesh konkrete të parisë shqiptare e udhëhequr nga Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi e të tjerë.

Gjatë verës së vitit 1912, kryengritja ishte shtrirë pothuajse në të gjitha trevat shqiptare, që nga Mitrovica në veri e deri te Çamëria në jug. Pasuan bisedimet shqiptaro-osmane dhe Memorandumi i 14 pikave që Hasan Prishtina i paraqiti në emër të kryengritësve shqiptarë. Por, ngjarjet zhvilloheshin me shpejtësi të madhe. Porta e Lartë nuk përgjigjej në kërkesat e kryengritësve. Forcat shqiptare nga Ferizaji marshuan drejt Shkupit, dhe me 12 gusht 1912 shtinë në dorë qendrën e Vilajetit të Kosovës. Çlirimi i Shkupit përbënte një fitore të rëndësishme e cila përgatiti terrenin për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë rreth tre muaj e gjysmë më vonë². Bajram Daklani, sipas gazetës “Shkupi”, shpalosi në qytet flamurin kombëtar shqiptar. Ushtarët osmanë nuk bënë asnjë qëndresë. Numri i kryengritësve në Shkup arriti në më shumë se 30.000 veta. Prej tyre afër gjysma qenë të armatosur vetëm me ndonjë kobure ose shpatë. Të paarmatosurit u pajisën me armë pasi u shpërthye depoja e ushtrisë. Bajram Curri, sapo hyri në Shkup, hapi burgun dhe liroi 960 të burgosurit e pranguar aty. Nga Shkupi grupe kryengritësish marshuan drejt Tetovës, Kumanovës e Preshevës dhe i çliruan edhe këto qytete, duke liruar gjithashtu të burgosurit. Një grup kryengritësish u drejtua për në Veles³.

Sipas historianit të njohur anglez, Noel Malkolm, kjo ishte pika kulminante e të gjitha luftimeve të ndryshme për njohjen kombëtare të shqiptarëve që nga viti 1878. Më në fund ishte arritimi pajtimi për formimin e një shteti shqiptar brenda Perandorisë Osmane, në të cilin do të zhvilloheshin me kohë institucionet kombëtare. Por nuk kishte kohë. Brenda dy muajsh, osmanët do të dëbohen nga pothuajse të gjitha territoret e tyre evropiane, dhe ç’është e drejta, vetëm kryengritja shqiptare e vitit 1912 i kishte bindur shtetet e Ballkanit se kishte ardhur koha për

² Jusuf Bajraktari, *Roli i Hasan Prishtinës në Kuvendin e Junikut*, Scupi - 4, ITShKSh, Shkup, 2012, f. 29.

³ *Historia e Popullit Shqiptar-II, Çlirimi i Shkupit*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 491.

një luftë kundërosmane, ndërkohë që osmanlinjtë ishin dobësuar aq shumë, sa që lufta u fitua me shpejtësi.⁴

Megjithatë, periudha pasuese ishte shumë e zymtë për shqiptarët e anës së Shkupit e Kumanovës, të cilët u gjendën në sundimin e egër serb, konkretisht nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroate Sllovene, deri në Luftën e Dytë Botërore. Ishte kohë e shtypjes sistematike, shpërnguljeve të shqiptarëve dhe e kolonizimit të këtyre trojeve me serbë e malazezë.

Në qytetin e Shkupit, më 28 nëntor 1942, në disa dyqane shqiptare u mbledhën dhjetëra burra dhe kënduan këngë patriotike në gjuhën amtare. Ndërsa nëpër shkollat (që zakonisht ishin shtëpi të atdhetarëve) u kënduan këngë për flamurin kuq e zi, për Skënderbeun dhe Ismail Qemalin. Paradoksalisht, në dhjetorin e vitit 1942, duke marrë shkas nga këto manifestime më të thjeshta në dukje, pushtuesit bullgar urdhëruan deri që, asnjë shqiptar nuk ka të drejtë të mbajë plis të bardhë në kokë! Plisi me shkabën dykrenore, ky simbol i kahershëm i shqiptarëve, tanimë duhej të hiqej, sepse sipas autoriteteve vendore bullgare “i nxit ata për t’u bashkuar”. Heqja e plisit u prit me revolta ndër krejt trevat shqiptare të Shkupit, Kumanovës e deri të Manastirit.⁵

3. Ngritja e flamurit shqiptar në Shkup dhe Mateç, më 1944

Vitet e Luftës së Dytë Botërore, ishin kohë mjaft të rënda. Shpresat e ujitura rrejtshëm nga fituesit e luftës për parimin e vetëvendosjes, përfunduan me ripushtimin jugosllav të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare që mbetën nën Jugosllavi. Një pikë kthese brenda asaj periudhe ishte shtatori i vitit 1944, kur edhe në këto vise u ngrit flamuri i Skënderbeut. Pra, 80 vjet më parë, Shkupi dhe Kumanova ngritën flamurin e lirisë dhe bashkimit me Shqipërinë, në rrethana shumë të turbullta historike.

Konkretisht, pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste⁶ më 8 shtator 1944, me direktivat e krerëve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Shkupi dhe Kumanova do t’i bashkëngjiten shtetit shqiptar. Më 9 shtator 1944, Komandanti Sulë Hotla shpalli zonën e lirë të prefekturës së Mateçit

⁴ Noel Malkolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, botimi i dytë, Koha - Prishtinë & Shtëpia e Librit -Tiranë, 2001, f. 259.

⁵ Eugen Shehu, *Maqedonia shqiptare*, SHB “Lumo Skendo”, Tiranë, 2002, f. 377.

⁶ Përveç rrethit të Shkupit dhe Kumanovës, brenda zonës okupuese bullgare ndodheshin edhe rrethi i Gjilanit, Kaçanikut, Vitisë, Preshevës e Bujanocit, ku llogaritej se jetonin rreth 130.000 shqiptarë.

dhe ngrit flamurin kuqezi para mijëra qytetarëve, të cilët me padurim e pritnin “Kohën e Shipnisë”. Në këtë tubim, veç këtyre dy figurave bënin pjesë edhe shumë krerë të njohur shqiptarë të kësaj ane, si: mulla Hajdari, Ali Staneci Jetulla Seferi, Azem Hoxha, Ferat Efendi, Enver Destani, Hamzë Bellanoci, Xhemal Efendi, Murat Jusufi, Ramadan Qazimi, e shumë të tjerë⁷. Para të pranishmëve, foli Sulë Hotla, i cili pasi njoftoi për bashkimin e këtyre tokave shqiptare me Shqipërinë, shtoi: “Ne do të qeverisim me këtë prefekturë, derisa nuk vjen një fuqi e madhe botërore”.⁸ Pas fjalës së tij, u zgjodhën edhe organet udhëheqëse të këtij organizimi, në rrethanat e reja që u krijuan me ikjen e bullgarëve. Me këtë rast, Mulla Dulla i Hotlës zgjidhet nënprefekt i prefekturës së Mateçit, ndërsa Sulë Hotla komandant i forcave të armatosura shqiptare të kësaj prefekturë, ku gravitonin komunitat e Mateçit, Likovës, Opajës, etj.

Në deklaratën e tij dhënë para këshillit ushtarak të Kumanovës më 3 janar 1945, Abdulla Ebibi (mulla Dulla), thotë: “Veprimtaria ime politike lidhet me ardhjen e Sulejman Asipit (Aga Sulë), më 9 shtator 1944, bashkëfshatar imi nga Hotla, me të cilin njihem që më herët. Ai erdhi personalisht me përcjellje të Jetullahut nga fshati Sefer, dhe më ftoi të bëhem Nënnprefekt për rrethin e Mateçit, në shtetin e ri shqiptar”.⁹

Në të vërtetë, në këtë kohë në Mateç u formuan dy shtabe, shtabi politik dhe ai ushtarak. Shtabin politik e udhëhiqte nënprefekti Abdulla Ebibi, komisar politik ishte mulla Hajdari i Orizarës, ndërsa anëtarë: mulla Xhema nga Nakushtaku, Refik Hasani nga Sllupçani, Nezir Rrahmani nga Llojani, e disa të tjerë. Kurse në shtabin ushtarak, i cili drejtohej nga Sulë Hotla, bënin pjesë: Ali Staneci, Destan Norça, Azem hoxha, Enver Destani, Faik Dalipi, Hamzë Bellanoca etj.¹⁰ Të gjitha udhëzimet dhe direktivat, Sulë Hotla dhe shtabi i tij i merrte nga Xhafer Deva dhe Hamit Kruja, të cilët realizuan një takim në Prizren, ku kishin vendosur që t’i luftonin partizanët, ndërsa për armatimin dhe municionin do të kujdesej Komiteti Qendror i Lidhjes së Dytë të Prizrenit¹¹.

Ndërkohë, edhe në Shkup u themelua Komiteti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kjo nismë, fillimisht rrodhi nga takimi i myderrizit të Tetovës, Hafëz Xhemil Efendiut me Sulë Hotlën, Xhemë Gostivarin,

⁷ Qerim Lita, *Shaban Efendia atdhetar i devotshëm*, Kumanovë, 2010, f. 149.

⁸ Po aty.

⁹ ASHRM / ДАРМ.1.893.3.45/236-239. Shih edhe: Q. Lita, *Shaban Efendia...*, f. 150.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, f. 151.

dy Mefailat dhe Aqif Reçanin, mbajtur në afërsi të Tetovës. Në atë takim Sulë Hotlës i jepet detyrë: “që me 50 vetë të futet në Shkup dhe për Bajramin e Madh ta ngrenë flamurin kombëtar.”¹² Mbështetur në atë vendim, Sulë Hotla në Gjilan takohet me Hamit Krujën, të cilin e informoi për vendimin e marrë.¹³

Në një deklaratë të dokumentuar, dhënë në organet e hetuesisë pas arrestimit, Sulë Hotla deklaroi: “Në marrëveshje me Hamit Krujën, rashë dakord se duhet të jap disa njerëz për mbajtjen e rendit. Kur Hamiti u nis për në Shkup, i dhashë 15 vullnetarë që t’i merr me vete. Kur themelova shtabin tim, kam marrë direktivë nga Xhafer Deva dhe Hamit Kruja”¹⁴. Kjo përputhet edhe me deklaratën e dhënë shumë më vonë nga njëri prej ushtarëve të Sulë Hotlës, Islam Ademi nga Nikushtaku, i cili kishte deklaruar se: “Në këtë kohë Sulë Hotla na zgjodhi 15 veta për të shkuar në luftë për çlirimin e Shkupit. Aty e takuam Arif Kapedanin që ishte me 100 veta. Ne e sulmuam një pjesë të Shkupit dhe e çliruam. Në Shkup na mbanin me ushqim shqiptarët e vendit. Shtabin e kishim te kafeneja e shqiptarëve, Merkez. Aty erdhën Xhemë Gostivari dhe Mefail Kërçova që të na uronin fitoret dhe u kthyen në rajonet e tyre”¹⁵.

Burime tjera flasin se forcat vullnetare shqiptare e kanë ngritur flamurin shqiptar tek Ura e Gurit në qendër të Shkupit. Sipas dëshmisë së Qemal Iljazit dhënë para organeve të OZN-as, “Arif Kapedani ka shkuar shpesh në Bojali Han në Shkup, në biseda me Hasan Shukrinë. Pas tërheqjes së bullgarëve, në këtë vend është mbajtur edhe një konferencë, ku kanë marrë pjesë: Xhafer Deva, Hasan Shukriu, Emin Jashari, Rashid Beu, Hamit Kruja, Arif Kapedani dhe tjerë, ku vendosën njëzëri për marrjen e Shkupit nga forcat vullnetare. Me ftesë të Hamit Krujës, në marrjen e Shkupit kanë marrë pjesë: Xhemë Gostivari, Arif Kapedani, Mefail Kërçova dhe shumë vullnetarë nga Gostivari dhe fshatrat e Tetovës dhe Dervenit. Këta pasi hynë në Shkup, mbajtën një konferencë me përkrahësit e tyre, në Medresenë ‘Isa Beu’. Pasi mbaroi tubimi,

¹² *Lidhja Kosovare - Kongresi i parë botnuer*, Chicago 24-25 nanduer 1973, bot. në mërgim, 1974, f. 70.

¹³ ASHRM / ДАРМ.Ф.УДБ-РСБР.К.11.Д.Космет.

¹⁴ Vebi Xhemaili, *Xhemë Hasa me vullnetarë në mbrojtje të Shqipërisë*, Tetovë, 2007, f. 172.

¹⁵ Tefik Jahiu, *Masakra serbosllave-maqedonase ndaj shqiptarëve në Karadak*, Shkup, 2000, f. 150.

me brohoritje u nisën kah Ura e Gurit, ku e ngritën lartë flamurin kombëtar shqiptar të Ismail Qemalit”.¹⁶

Gjatë kësaj periudhe, forcat shqiptare bënë rezistencë të madhe, duke zhvilluar luftime të përgjakshme me forcat partizane përgjatë gjithë territorit shqiptar. Nga raporti i Komandës Ushtarake Partizane më 10 shtator 1944, thuhet se: “Forcat partizane nuk mund të hyjnë në fshatrat shqiptare për shkak të rezistencës së forcave balliste, prandaj nëse ka nevojë ne do të djegim ndonjë fshat me të vetmin qëllim që t’i frikësojmë fshatarët që të mos u ndihmojnë forcave balliste”.¹⁷

Beteja të mëdha ndërmjet forcave atdhetare shqiptare me ato partizane-çetnike janë zhvilluar gjatë muajve nëntor-dhjetor, në Niku-shtak, Orizare, Vaksincë, Hotël, etj.¹⁸ Gjatë këtyre luftimeve kishte humbje të mëdha nga të dy anët. Për arsye strategjike forcat shqiptare ishin të detyruara të tërhiqeshin në viset malore të Karadakut për të bërë konsolidimin e forcave të veta, ndërsa forcat partizane filluan torturat dhe masakrat ndaj shqiptarëve, nga të ashtuquajturit “çlirimtarë të rinj”. Në këtë periudhë i tërë rrethi i Karadakut ka qenë i përfshirë në luftë për të mbrojtur vatrat e tyre. Për këtë qëllim luftimet kanë vazhduar edhe gjatë fillimit të vitit 1945, por ndryshimi i forcave në nivel global, solli në pushtet një sundues të ri antishqiptar.

Sidoqoftë, periudha shtator-nëntor 1944, në kujtesën e popullatës vendase mbeti e ngulitur si koha e ‘Shipnisë së vogël’, apo siç thuhet në anën e Kumanovës: ‘Tre muajt e Agës Sulë’!

4. Beteja për flamur kombëtar pas mbarimit të LDB-së

Qëndresa e shqiptarëve të anës së Shkupit dhe Kumanovës, vazhdoi edhe në rrethanat e reja pas vendosjes së pushtetit komunist jugosllav në Maqedoni. Gjatë vitit 1945 këto treva ishin çerdhe të një organizate të re politike, që kishte për qëllim bashkimin me shtetin amë, ishte kjo Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare, e njohur me shkurtesën NDSH. Veprimtaria e saj patriotike në këto anë personifikohet me Gjon Sereçin, Azem Maranën, Sulë Hotlën, Mulla Hajdarin, Hasan Bilallin, Qemal Skënderin e të tjerë. Fatkeqësisht, të gjithë këta

¹⁶ OZN-a, kut.12, Dëshmi e Qemal Rasim Iljazit, 8.12.1948; Shih edhe: Vebi Xhemaili, *Xhemë Gostivari - Ikona e trimërisë shqiptare (1941-1945)*, Tetovë, 2023, f. 299.

¹⁷ ASHRM, Raport i Komandës Ushtarake dërguar Shtabit Suprem të LNÇ-së më 10.9.1944. dos. 3840, f. 2, k.52.

¹⁸ ASHRM, Raport i Shtabit të Brigadës 17 dërguar Shtabit të LNÇ-së të Divizionit të Kumanovës më 16 nëntor 1944, dosja 5036.

atdhetarë të devotshëm, që kundërshtuan hapur regjimin e ri komunist jugosllav, u burgosën dhe u likuiduan nga viti 1945 e deri në vjeshtën e vitit 1947. Por, zëri liridashës i shqiptarëve të kësaj ane kurrë nuk u shua.

Viti 1968 ishte një vit i rizgjimit kombëtar, kur po shënohej anembanë trojeve shqiptare 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut. Reshat Latifi nga Shtraza e Karadakut, arsimtar i biologjisë dhe kryetar i Pleqësisë në Shkollën Fillore “Bajram Shabani” të Kumanovës, i nxitur nga debatet që po bëheshin në gjithë vendin për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, kah mesi i nëntorit të vitit 1968, e var flamurin kuqezi në zyrën e arsimtarëve të shkollës. Menjëherë alarmohen organet e shkollës dhe ato partiake-police të cilat e marrin në biseda informative dhe në Gjykatën e Kumanovës i shqiptojnë një dënim me një muaj burg, të cilin për një kohë do ta evitojë përmes ankesave. “E nuhata që shteti jugosllav do të hakmerrej ndaj meje, andaj kur erdhi dita e 28 Nëntorit 1968, duke u thirrur në ligjin i cili na e mundësonte një gjë të tillë, me një grup shokësh e nxënësish, flamurin kombëtar e ngrita në ballkonin e shkollës, flamur ky i sjellë nga njerëzit e ilegales nga Gjakova”, theksoi Latifi. Edhe në këtë rast kishin reaguuar organet e punëve të brendshme, të cilat në fillim të muajit shkurt 1969 e burgosin 30 ditë, ku përjeton trauma të rënda nga ana e punëtorëve të sigurimit shtetëror¹⁹.

Edhe familja atdhetare Bekteshi, me origjinë nga Muhoci i Bujanocit, është një flamurtare, e cila dallohet për guximin dhe krenarinë e shprehur me rastin e shënimit të 28 Nëntorit të vitit 1968. Në mesin e saj shquhej mësuesi dhe intelektual Shfaqet Bekteshi (1920-1987), i cili kishte qenë frymëzues i familjes dhe mbjellës i atdhedashurisë te nxënësit dhe fëmijët²⁰ e tij, të cilët më vonë u bënë të njohur nëpër demonstrata dhe procese të rëndësishme kombëtare. Sipas dëshmitarëve, flamurin e kishin sjellë nga Gjilani në Shkup, Bektesh Bekteshi, Shaban Laçi e Mustafë Kajolli, dhe i njëjti ishte planifikuar

¹⁹ Deklaratë e Reshat Latifit, (v.l. 1944), dhënë më 30.11.2018, Kumanovë; Shih edhe: “*Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë*”, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2018.

²⁰ Teuta Bekteshi (v.l.1957), si studente e mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, merr pjesë aktive në organizimin e demonstratave studentore të vitit 1981 në Prishtinë, dhe më pas u arrestua tri herë nga organet e sigurimit shtetëror dhe u dënua me burg, të cilin e vuajti deri në vitin 1985; Fatmir Bekteshi (v.l.1960), pjesëmarrës në demonstratat studentore të vitit 1981 në Prishtinë, u dënua me 60 ditë burg në Kumanovë; Fadil Bekteshi (1955-1998), shkrimtar, gazetar dhe përkthyes i Radiotelevizionit të Prishtinës, diferencohet nga puna në vitin 1982.

të ngritët në Shkup, por meqë u dyshua se grupit i ranë në gjurmë organet e sigurimit, një natë para festës, Selver Bekteshi, e bartë flamurin në këmbë nga Shkupi e deri në Llopat të Kumanovës. Ai bashkë me familjarët, miq dhe fqinj, në mëngjesin e 28 nëntorit 1968 (rreth orës 8:00), e ngritë flamurin kuqezi në objektin ndihmës të shtëpisë së vëllait të tij, Mehmet Bekteshi. Meqë objekti ndodhej rreth rrugës kryesore që lidhë Kumanovën me fshatrat e Karadakut dhe Shkupit, ishte një manifestim i guximshëm i ndjenjave kombëtare. Ishte hera e parë që kjo festë po manifestohej, dhe për shumë njerëz të kësaj ane, kjo ishte hera e parë që po e shihnin me sy flamurin shqiptar²¹. Për këtë ngjarje pa dyshim se ishin informuar edhe organet e Punëve të Brendshme në Kumanovë, por falë disa shqiptarëve të angazhuar në ato shërbime, ngjarja kishte kaluar në heshtje, pra nuk ishin ngritur masa, me të cilat do të provokohej dhe destabilizohej gjendja e sigurisë në Kumanovë e më gjerë.

Në valët e demonstratave të vitit 1968 u gjend edhe nxënësi Xhevxhet Latifi (i lindur më 19.9.1952 në fshatin Hotël të Kumanovës). Ai derisa vijonte mësimet e vitit të parë të Shkollës Normale të Shkupit “Zef Lush Marku”, me disa shokë mori pjesë në demonstratat e Prishtinës. Prej atje kishte bartur me vete një flamur, të cilin e vuri para objektit të Shkollës Normale të Shkupit. Për këtë akt të guximshëm, organet kompetente morën masa menjëherë. Xhevxheti largohet nga shkolla, por ai arratiset në Bosnjë për pak kohë, dhe prapë kthehet në vendlindje, ku vazhdon protestën e tij kundër pushtetit komunist jugosllav. Në muret e ambulancës së fshatit Likovë, shënoi parullën “Poshtë komunizmi! Kosova Republikë!”. Derisa, në festimet e 25 majit nëpër shitoret e fshatit vendoseshin flamuj jugosllav, Xhevxheti rrëfen se nga mllefi i madh kundër pushtetit, ngjitet lartë në shtizën e flamurit të vendosur para shitores “Zhitomel” në Hotël, e heq flamurin jugosllav dhe e bën copë-copë! Pas këtyre rasteve, ai kërkohej nga organet e pushtetit, dhe në verën e vitit 1969, arrestohet në Kumanovë, dhe mbahet katër muaj nën hetime në burgun e Shutkës. Gjyqi i Rrethit të Shkupit, më 25.6.1969, e dënoi me 18 muaj burg, për vepër penale “veprimtari armiqësor kundër popullit dhe shtetit”. Dënimin e vuajti në burgun e Valevës në Serbi. Pas daljes nga burgu, Xhevxhet Latifi u largua nga vendlindja e tij - Hotla, dhe shkoi në Bosnjë, ku edhe sot e kësaj dite jeton me familje²². Ndërkohë, në lidhje me incidentet e shkaktuara nga ky i ri në Hotël e Likovë, shprehet brengosje e thellë

²¹ Deklaratë e Selver Bekteshit (v.l. 1942), dhënë më 1.9.2018, Kumanovë.

²² Minir Ademi, *Hotla nëpër kohë*, Kumanovë, 2017, f. 32-233.

edhe në mbledhjen e përbashkët të aktivitetit të Lidhjes Komuniste, LSPP-së dhe LR-së në Likovë të Kumanovës, më 26 dhjetor 1968²³.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shkupi e humbi pozitën e një qendre të rëndësishme të koncentrimit të shqiptarëve, si rezultat i ndryshimeve artificiale të popullsisë, ikjes masive të shqiptarëve për në Turqi, dhe sjelljes së maqedonasve nga viset e tjera të Maqedonisë lindore. Megjithatë, shumë veprimtarë të lëvizjes ilegale shqiptare nga Kosova dhe viset tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë, një pjesë të veprimtarisë së tyre atdhetare e zhvilluan edhe përmes Shkupit e Kumanovës, në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar. Luftërat çlirimtare të UÇK-së në Kosovë (1998-1999) dhe në Maqedoni (2001), u bënë me betimin mbi flamurin kombëtar, dhe kishin po atë motiv sikurse shumë gjenerata para tyre që luftuan për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar. Këto ideale përcillen edhe sot e kësaj dite deri te brezi i ri, si një amanet ende i parealizuar deri në fund!

Conclusions

In all historical periods, the Albanians of the Skopje and Kumanovo region have fought and made continuous efforts to become part of the Albanian common state. There are historical facts about their concrete commitments since the Balkan wars of 1912, then the years of World War II and up to the liberation wars of the Albanians in the Balkans by the end of the 20th century. The Albanians of this area have also shown their ideals with concrete deeds, such as raising of the Albanian flag as a sign of victory and unification with Albania.

These freedom-loving efforts also speak of the historical injustices that were done to the Albanians at international conferences, leaving more than half of the Albanian lands outside the borders of Albanian state (London 1913). Therefore, the ideals and efforts of the Albanians for national unification have not stopped yet.

Recensentë:

Prof. dr. Besnik Rameti

Prof. dr. Isamet Bakiu

²³ Shih: Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974 - Demonstratat e vitit 1968*, Vëllimi IV, Logos-A, Shkup, 2021, f. 167-168.

Literatura:

1. Ademi Minir, “Hotla nëpër kohë”, Kumanovë, 2017
2. “Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë”, ITShKSh, Shkup, 2018
3. Demiri Sevdail, “Flakadani rezistencës karadakiane”, Jehona e Karadakut, Kumanovë, 2006
4. Demiri Sevdail, “Variacione historike“ (punime shkencore), SHHSHM, Shkup, 2017
5. Demiri Sevdail, Asani Skender, “Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar (1941-1944), në dritën e dokumenteve shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2018
6. “Historia e Popullit Shqiptar” vëll. II, Botimet Toena, Tiranë, 2002
7. Jahiu Tefik, “Masakra serbosllave-maqedonase ndaj shqiptarëve në Karadak”, Shkup, 2000
8. Lita Qerim, “Shaban Efendia atdhetar i devotshëm”, Kumanovë, 2010
9. Lita Qerim, “Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974 – Demonstratat e vitit 1968”, Vëllimi IV, Logos-A, Shkup, 2021
10. “Lidhja Kosovare – Kongresi i parë botnuer, Chicago 24-25 nanduer 1973”, bot. në mërgim, 1974
11. Malkolm Noel, “Kosova – një histori e shkurtër”, botimi i dytë, Koha – Prishtinë & Shtëpia e Librit –Tiranë, 2001
12. Shehu Eugen, “Maqedonia shqiptare”, SHB “Lumo Skendo”, Tiranë, 2002
13. “Scupi” - 4, Kumtesa e Jusuf Bajraktarit: “Roli i Hasan Prishtinës në Kuvendin e Junikut”, ITShKSh, Shkup, 2012
14. Xhemaili Vebi, “Xhemë Hasa me vullnetarë në mbrojtje të Shqipërisë”, Tetovë, 2007